



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

**Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice**

---

**UDHËZIM ADMINISTRATIV MD- NR.18/2023<sup>1</sup>**  
**PËR FORMËN DHE PËRMBAJTJEN E FORMULARIT PËR**  
**PARAQITJEN E KËRKESËS PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS**

---

<sup>1</sup> Udhëzim Administrativ MD - Nr. 18/2023 për formën dhe përmbajtjen e formularit për paraqitjen e kërkesës për ndihmë juridike falas, i nënshkruar nga Ministria e Drejtësisë më datë 22.12.2023

## **Ministrja e Ministrisë së Drejtësisë,**

Në mbështetje të nenit 31 (paragrafi 2) të Ligjit Nr. 04/L-017 për Ndhmë Juridike Falas (Gazeta Zyrtare Nr. 03, 22.02.2012), në përputhje me nenin 11, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në Shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores (QRK) - NR. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe nenin 38 paragrafit 6 të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare Nr. 15, 12.09.2011),

Nxjerr:

### **UDHËZIM ADMINISTRATIV (MD) - NR.18/2023 PËR FORMËN DHE PËRMBAJTJEN E FORMULARIT PËR PARAQITJEN E KËRKESËS PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS**

#### **Neni 1 Qëllimi**

Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim përcaktimin e formës dhe përmbajtjes së formularit për paraqitjen e kërkesës për ndihmë juridike falas.

#### **Neni 2 Fushëveprimi**

1. Ky Udhëzim Administrativ zbatohet për të gjithë personat që kërkojnë ndihmë juridike falas nga Agjencia për Ndhmë Juridike Falas dhe ofruesit e ndihmës juridike falas.

#### **Neni 3 Forma e formularit**

1. Të gjithë kërkuessit e ndihmës juridike falas duhet të paraqesin kërkesën e tyre për ndihmë juridike falas sipas Formularit në shtojcën 1 të këtij Udhëzimi.
2. Të gjithë ofruesit e ndihmës juridike falas obligohen të vlerësojnë përmbushjen e kriterëve të kërkuessve të ndihmës juridike falas në përputhje me Formularin.

#### **Neni 4 Forma e dorëzimit të formularit**

1. Kërkuessit e ndihmës juridike falas mund të parashetrojnë kërkesë për ndihmë juridike falas duke dorëzuar formularin në një rën prej formave si në vijim:

- 1.1. dorëzimit të kërkesës në një rën nga zyrat e Agjencisë për Ndhmë Juridike Falas;

1.2.përmes email;

1.3.përmes postës.

2. Në rast të dorëzimit të Formularit për paraqitjen e kërkesës për ndihmë juridike falas përmes email apo përmes postës, nëse kërkuesi e dorëzon kërkesën e mangët me informata apo dokumente, ofruesi i ndihmës juridike falas kontakton palën për plotësim të formularit, nëse kontakti është i mundshëm.

3. Në rast se kërkuesi i ndihmës juridike falas nuk e plotëson formularin sipas udhëzimeve të ofruesit të ndihmës juridike falas dhe me informatat të cilat ofruesi i posedon, kërkesa refuzohet.

4. Refuzimi i kërkesës për ndihmë juridike falas në bazë të mungesës së informatave apo dokumenteve në formularin e kërkesës për ndihmë juridike falas, nuk e përjashton të drejtën e kërkuesit të parashtojë kërkesë të re në çdo kohë.

5. Formulari i kërkesës për shërbime të ndihmës juridike falas mund të paraqitet nga vetë pala, kujdestari apo i autorizuari i tij ligjor.

6. Të dhënat e paraqitura në formularin e kërkesës për ndihmë juridike falas regjistrohen drejtpërdrejtë në bazën elektronike të të dhënave dhe në librat e ndihmës, libri për evidentimin e palëve.

7. Zyrtarët e Zyrës për Ndihmë Juridike Falas obligohen që të këshillojnë kërkuesin për të plotësuar formularin e kërkesës për ndihmë juridike falas.

8. Formulari i kërkesës duhet të plotësohet në tërësi në përputhje me rastin dhe dëshmitë e ofruara.

## **Neni 5**

### **Përmbajtja e formularit për paraqitjen e kërkesës për ndihmë juridike falas**

1. Formulari për paraqitjen e kërkesës për ndihmë juridike falas përmban të dhënat e përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni dhe duhet të jetë i plotësuar në tërësi.

2. Formulari për paraqitjen e kërkesës për ndihmë juridike falas përmban të dhënat si në vijim:

2.1. të dhënat personale të parashtruesit të kërkesës për ndihmë juridike falas. Plotësimi i të dhënave bëhet në përputhje me letërnjoftimin, leje qëndrimin ose ndonjë dokument tjetër të lejuar me ligj apo rregulla të tjera vendore apo ndërkombëtare;

2.2. të dhënat personale të anëtarëve të familjes në bashkësinë familjare me të cilët jeton parashtruesi i kërkesës për ndihmë juridike falas. Këto të dhëna duhet të plotësohen në përputhje me deklaratën e bashkësisë familjare, të cilën duhet ta sjell parashtruesi i kërkesës për ndihmë juridike falas. Të dhënat lidhur me personat në bashkësi familjare me të cilët jeton parashtruesi i kërkesës për ndihmë juridike falas, duhet të plotësohen në përputhje me dëshmitë e ofruara nga kërkuesi.

2.3. të dhënat për gjendjen financiare të parashtruesit të kërkesës dhe personave që jetojnë në bashkësi familjare me parashtruesin. Të dhënat mbi gjendjen financiare të parashtruesit të kërkesës për ndihmë juridike falas dhe personave në bashkësi familjare me të cilët jeton, përfshin të dhënat lidhur me të hyrat mujore, shpenzimet mujore, borxhet dhe pasurinë të

cilën e posedon bazuar në dëshmitë e bashkëngjitura në formularin e kërkesës

2.4. të dhënat lidhur me çështjen juridike të cilin e ka kërkuesi i ndihmës juridike falas.

2.5. të dhënat për dokumentacionin e bashkëngjitur në formularin e kërkesës. Këto të dhëna duhet të plotësohen në tërësi duke i shënuar të gjitha dokumentet të cilat i janë bashkëngjitur formularit.

2.6. deklaratën e parashtruesit të kërkesës për ndihmë juridike falas dhe nënshkrimin e parashtruesit të kërkesës. Është e detyrueshme që kjo pjesë të nënshkruhet ose vënie gishti nga parashtruesi i kërkesës për ndihmë juridike falas, në të kundërtën kërkesa për ndihmë juridike falas e parashtruesit konsiderohet se nuk është bërë.

2.7. të dhënat juridike lidhur me veprimet juridike të cilat ndërmerren nga ofruesi i ndihmës juridike falas, plotësohen sipas veprimeve të ndërmarra, të dhënat juridike në rastet e referimit të rastit tek avokati ose te ndonjë institucion tjetër dhe duhet të plotësohet çdo herë. Kjo pjesë e formularit të kërkesës duhet të përmbajë edhe të dhënat juridike lidhur me vendimin për miratimin apo refuzimin e ndihmës juridike falas dhe arsyen e miratimit apo refuzimit.

## **Neni 6 Te dhënat personale**

Të dhënat personale të kërkuarit të ndihmës juridike falas trajtohen në pajtim me Ligjin përkatës për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

## **Neni 7 Shtojca**

1. Pjesë e këtij Udhëzimi Administrativ është:

1.1. Formulari për Paraqitjen e Kërkesës për Ndihmë Juridike Falas.

## **Neni 8 Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi (7) shtatë ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albulena Haxhiu**

\_\_\_\_\_  
Ministre e Drejtësisë

22/12/2023



NDIHMJA JURIDIKE | PRAVNA POMOC  
LEGAL AID

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

**Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice**

**Agjencia për Ndhmë Juridike Falas - Agencija za Besplatnu Pravnu Pomoć - Free Legal Aid Agency**

**FORMULARI PËR PARAQITJEN E KËRKESËS PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS**

**Nr. Lëndës (të plotësohet nga ANJF):**

*Udhëzime: Ju lutem pergjigjuni në të gjitha pyetjet që përshtaten për rastin tuaj, dhe bashkëngjitni dokumentet. Nëse pyetjet nuk përshtaten lidhur me rastin tuaj shkruani (Nuk aplikohet). Formulari i pa kompletuar mund të ju kthehet për informata shtesë apo mund të anulohet procesimi e aplikacionit tuaj. Nëse ju duhet ndihmë, njeri nga zyrtarët mund të ju ndihmojë që të plotësoni këtë formular. Dorëzimi i formularit të kërkesës për ndihmë juridike falas mund të bëhet fizikisht, online ose përmes postës.*

**I. Të dhënat personale të kërkuarit të ndihmës juridike falas**

**1 Gjinia**  Femër  Mashkull

**2 Emri (emri i prindit) Mbiemri**

**3 Numri personal**

**4 Data e lindjes**  d / m / viti

**5 Adresa e vendbanimit**

  
  
  

**6 Adresa postale**

(Nëse ndryshon nga vendbanimi)

7 Nr. i Telefonit

8 Email adresa

9 Statusi Martesor  I/e martuar  I/e pamartuar  I/e divorcuar  I/e ve

10 Profesioni

11 Përkatësia etnike  Shqiptare  Serbe  Rome  Ashkalike

Egjiptase  Turke Tjetër (specifiko)

12 Shtetësia

13 A keni ndonje rrethanë personale të veçantë? (p.sh jeni përfitues/e e asistencës sociale, përfitues i ndonjë skeme tjetër pensionale, viktimë e dhunës në familje, etj.)

**II. Të dhënat për anëtarët e familjes në bashkësinë familjare**

14 A keni anëtarë të familjes që jetojnë me ju? Po  Jo

Nëse po – plotësoni të dhënt e mëposhtme:

Emri dhe mbiemri	Lidhja Familjare	Viti i Lindjes		Profesioni	Të ardhurat mujore

### III. Të dhënat mbi gjendjen financiare

#### 15 Të ardhurat mujore të juaja dhe të anëtarëve të familjes

Lloji i të ardhurave mujore	Personale	Të anëtarëve të familjes
Të ardhurat mujore nga paga		
Të ardhurat nga biznesi/vetëpunësimi		
Të ardhurat nga qiraja		
Të ardhura tjera ( <i>specifiko</i> ): _____		
_____		
_____		
<b>Ndihma nga shteti:</b>		
1. Skemë sociale ( <i>specifiko</i> ) _____		
2. Ndihmë e aftësisë së kufizuar		
2 <i>Tjetër</i> . ( <i>specifiko</i> ) _____		
_____		

#### Pasuria (asetet dhe borxhet)

Po  Jo

#### 16 A keni pronë të luajtshme dhe të paluajtshme? (nëse po – plotësoni informatat e mëposhtme)

Lloji i Pronës	Vlera në Euro	A është pronësia e kontestueshme		
		Po <input type="radio"/>	<input type="radio"/>	Jo
		Po <input type="radio"/>	<input type="radio"/>	Jo
		Po <input type="radio"/>	<input type="radio"/>	Jo

**17** A keni para të gatshme? (nëse po – plotësoni informatat e mëposhtme)

Po  Jo

Përshkrimi	Shuma në Euro
Të deponuara	
Të huazauara te personat tjerë	
Të investuara	

**18**

Përshkrimi	Shuma në Euro
Shpenzimet mujore tuajat dhe të familjes	
Qiraja	
Borxhet (Specifiko): _____	
Kredia	
Tjetër (Specifiko): _____	

**19** Shuma e të ardhurave të mbetura pas kalkulimit të shpenzimeve



#### IV. Të dhënat lidhur me çështjen juridike

#### 20 Përshkruani shkurtimisht çështjen juridike

#### V. Dokumentacioni i bashkëngjitur

#### 21 Ju lutem bashkëngjitni dokumentet në vijim:

**Kopjen e letërnjoftimit**

**Kopjen e karteles sociale.**

**Dëshmi mbi të ardhurat mujore personale dhe të anëtarëve të familjes**

**Dëshmi mbi shpenzimet mujore dhe obligimet tjera financiare**

**Dokumente relevante për rastin (akgjykim, vendim, ankesë, kontratë etj).**

## VI. Deklarata e kërkesit të ndihmës juridike falas

Jam në dijeni se e drejta ime për ndihmë juridike falas mund të ndërpritet në qoftë se zbulohet që kam dhënë informacione të rrejshme. Agjencia për Ndihmë Juridike Falas ka të drejtë të kërkojë që të kthej çdo shpenzim që në emrin tim është paguar për ofrimin e ndihmës juridike.

Pajtohem që Agjencia për Ndihmë Juridike Falas mund të kërkojë dokumentacione të nevojshme, në mënyrë që të konfirmojë të drejtën time për ndihmë juridike. Gjithashtu, për këtë qëllim edhe nga organet qeveritare mund të kërkojë të dhëna tjera të nevojshme.

Pajtohem që kam për obligim menjëherë të njoftoi Zyrën për Ndihmë Juridike për çfarëdo ndryshimi të gjendjes time faktike, që ndikon në marrjen e së drejtës dhe në ndërprerjen e ofrimit të ndihmës juridike.

Në qoftë se lënda ime e financuar nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, në shqyrtimin gjyqësor mbaron me sukses, pajtohem që Agjencia ka të drejtë të kërkojë që shpenzimet e krijuara procedurale, që bien në barrë të palës tjetër në kontest, të derdhen në buxhetin e Agjencisë.

Me plotë përgjegjësi morale, personale dhe penale, deklaroj se informatat dhe dokumentet e ofruara me aplikacion janë të vërteta dhe të sakta.

**Emri e Mbiemri:**

**Data:**

**Nënshkrimi i palës:** \_\_\_\_\_

## VII. Veprimet e ofruesit të ndihmës juridike falas

Ky pasues plotësohet nga ofruesi i ndihmës juridike falas

<b>Lëmia juridike</b>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
	<b>Civile</b>	<b>Penale</b>	<b>Administrative</b>	<b>Kundërvajtëse</b>
<b>Natyra e lëndës</b>				
<b>Organi të cilit i drejtohet</b>				
<b>Pala e kundërt</b>				
<b>Përshkrimi i çështjes juridike</b>				
<b>Veprimi Juridik</b>	<input type="radio"/> Këshilla <input type="radio"/> Përpilim i shkresës (specifiko): _____ <input type="radio"/> Përfaqësim			
<b>Lënda referohet</b>				
<b>Vendimi mbi kërkesën për ndihmë juridike falas</b>	<input type="radio"/> Aprovohet	<input type="radio"/> Refuzohet		
<b>Arsyeshmëria e ofrimit/refuzimit të ndihmës juridike falas</b>	<input type="radio"/> Kriteri kualifikues <input type="radio"/> Kriteri financiar <input type="radio"/> Kriteri juridik			

Zyrtari i Ndihmës Juridike \_\_\_\_\_